



MALI I ZI
KOMUNA E ULQINIT
KOMISIONI PËR ALOKIMIN E MJETEVE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

Numër: 01-056/23-1376/3
Ulqin, më dt. 08.09.2023.

Në bazë të nenit 18, paragrafi 1 i Vendimit për kriteret, mënyrën dhe procedurën e alokimit të mjeteve për organizatat joqeveritare ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 42/18), Komisioni për alokimin e mjeteve për organizatat joqeveritare, shpall

KONKURS PUBLIK
për ndarjen e mjeteve buxhetore të Komunës së Ulqinit dedikuara për mbështetjen e projekteve të organizatave joqeveritare për vitin 2023

Ftohen organizatat joqeveritare të regjistruara në Mal të Zi me seli në Komunën e Ulqinit, të cilat janë të regjistruara deri në ditën e shpalljes së këtij konkursi, që të paraqesin aplikimet e tyre për Konkursin Publik për Alokimin e Mjeteve Buxhetore të Komunës së Ulqinit, të dedikuara për mbështetjen e projekteve të organizatave joqeveritare për vitin 2023.

Bazuar në Vendimin për fushat me përparësi për vitin 2023, që e ka miratuar Kryetari i Komunës Nr. 01-056/23-1376/2 të datës 01.09.2023, janë përcaktuar fushat e mëposhtme:

- I. Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara;
- II. Arsimi institucional dhe joinstitucional, shkenca, arti, kultura;
- III. Mbrojtja e mjedisit, bujqësia dhe zhvillimi rural, zhvillimi i qëndrueshëm;
- IV Barazia gjinore;
- V. Fusha të tjera me interes publik

Me Buxhetin e Komunës për vitin 2023 janë parashikuar mjete në vlerën prej 65.000,00 € (gjashtëdhjetë e pesë mijë euro) për alokimin e mjeteve për OJQ-të.

Organizatat joqeveritare paraqesin aplikimin për konkurs në Komisionin për shpërndarjen e mjeteve për organizatat joqeveritare përmes Byrosë së qytetarëve ose me postë në formularin e parashikuar, të cilin mund ta shkarkoni nga sajt i Komunës. Me aplikimin në zarfin e mbyllur dorëzohen edhe:

- dëshmia se organizataes joqeveritare është e regjistruar në Mal të Zi dhe se e ka selinë në territorin e Komunës së Ulqinit;
- një kopje të pasqyres financiare (bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit) për vitin e fundit fiskal, përveç nëse organizata është regjistruar në vitin kur është shpallur konkursi,
- raport për projektet e realizuara në vitin paraparak, duke përfunduar me ditën e shpalljes së konkursit;
- projekti me të cilin organizata joqeveritare është aplikon për alokimin e mjeteve;
- deshëmi (deklaratë) e personit të autorizuar për të përfaqësuar dhe prezantuar organizatën joqeveritare që nuk ka marrë fonde nga një donator tjetër në shumën totale të nevojshme për zbatimin e projektit që po aplikon;
- një deklaratë nëse organizata joqeveritare ka dorëzuar projektin kandidat tek një donator tjetër për shqyrtim në periudhën e mëparshme ose në kohën e paraqitjes në konkursin e Komunës;
- tre versione të shtypura dhe një elektronik të projektit në CD.

Organizata joqeveritare me dokumentacionin e përmendur mund të paraqesë rekomandimet e ekspertëve ose dokumentacion tjetër përkatës.

Organizata joqeveritare e cila për realizimin e projekteve ka shfrytëzuar mjete buxhetore sipas një konkursi publik në vitin paraprak duhet të paraqesë:

- raport mbi zbatimin e projekteve me një përshkrim të hollësishëm të fazave të zbatimit dhe një shpjegim të hollësishëm të devijimeve të mundshme;
- raport i detajuar financiar për mjetet e shpenzuara për vitin paraprak;
- kopje të llogarisë, kontratës dhe pasqyrës bankare sipas të cilës janë paguar, dhe
- raport narrativ me një pasqyrë tabelare të kostove për mjetet e shpenzuara.

Nëse organizata joqeveritare nuk dorëzon raportin e kërkuar për projektet e realizuara nga vitet e kaluara, të cilat janë financiar nga buxheti i Komunës, nuk mund të marrin pjesë në shpërndarjen e mjeteve për këtë vit.

Organizata joqeveritare mund të konkurojë për shumën totale ose një pjesë të mjeteve për realizimin e aktiviteteve nga projekti ose programi dhe është i detyruar ta theksojë atë.

Përmbajtja e projektit për të cilin ndahen mjetet duhet të përmbajë:

- emrin e organizatës, me të dhënat themelore (selia, telefoni / faksi i kontaktit, e-mail, numrin e të punësuarve, qëllimet e organizatës);
- emrin e projektit;
- kategorinë - fushën prioritare të projektit;
- përmbajtjen e shkurtër të projektit;
- objektivat e projektit;
- përshkrimin e lidhjes së projektit me politikën publike (strategjitë, planet e veprimit, aktet ligjore dhe nënligjore) në fushën e përmendur të miratuar nga Komuna ose Shteti;
- përshkrimin e grupit të synuar;
- përshkrimin e hollësishëm të aktiviteteve të projektit;
- afatin për zbatimin e projektit;
- mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të suksesit të realizimit të projektit;
- qëndrueshmërinë e projektit;
- buxhetin e projektit dhe shumën e mjeteve të kërkuara, shumën e mjeteve vetanake (pjesëmarrja), si dhe shumën e mjeteve të aprovuara për të njëjtin projekt ose program nga donatorë të tjerë, nëse mjetet e tilla janë aprovuar;
- përshkrim i shkurtër i projekteve të realizuara në vitin paraprak;
- një përshkrim i shkurtër i organizatës partnere dhe projekteve të implementuara në vitin paraprak (nëse ka);
- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës për realizimin e projektit ose programit me të dhënat e kontaktit;
- të dhënat për anëtarët e organit drejtues të organizatës;
- numri i xhiro llogarisë dhe NIPT (PIB) i organizatës.

Aplikimet jo të plota ose pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur për 30 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore "Pobjeda", në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, tabelën e shpalljeve të Komunës, dhe përmes transmetuesve lokalë publik deri me dt. 07.10.2023.

Vlerësimi i pikëve të projektit kryhet nga vlerësues të pavarur, në përputhje me kriteret e përshkruara me Vendim, pas së cilës Komisioni do të përcaktojë listën e projekteve të vlerësimit, dhe do të marrë një vendim për alokimin e mjeteve për organizatat joqeveritare.

Vlerësimi përfundimtar i projektit në fushat e konfirmuara nga Kryetari si përparësi për vitin 2023. rritet me 10 pikë.

Shuma maksimale e mjeteve që ndahen për projektin për një organizatë joqeveritare nuk mund të jetë më shumë se 15% e mjeteve totale të alokuara në buxhetin e Komunës për financimin e projekteve, përkatësisht programeve të organizatave joqeveritare.

Projekti, përkatësisht programi i organizatës joqeveritare financohet në shumën, e cila nuk mund të jetë më pak se 80% e shumës së mjeteve të kërkuara në aplikimin në Konkursin publik.

Në rast se projekti, përkatësisht programi i organizatës joqeveritare nuk mund të financohet në shumën e mjeteve, e cila deklarohet në kërkesë, Komisioni do të kërkojë nga organizata joqeveritare shpjegime në të cilat organizata joqeveritare përgjigjet brenda 10 ditëve.

Vendimi për shpërndarjen e mjeteve për organizatat joqeveritare u dorëzohet pjesëmarrësve në konkurs, që do të publikohet në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, në tabelën e shpalljeve të komunës dhe përmes transmetuesve lokalë publik.

Kryetari i Komunës brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së vendimit lidhë kontratë me organizatën joqeveritare, të cilës i janë alokuar mjetet, përmes së cilës rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta, dinamikën e pagesës, raportimin dhe mbikëqyrjen mbi realizimin e projektit, përkatësisht programit.

Realizimi i marrëveshjes së lidhur përcillet nga Komisioni.

Informacionet për të gjitha çështjet me rëndësi që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në Konkurs mund të merren ne Sekretarijatin për kulture, sport, rini dhe veprime shoqërore (Zyra nr.26), përmes e-mailit: artan.cobi@ul.gov.me ose përmes tel: 067-676-469.

KRYETARI KOMISIONIT

Sabri Salaj

